



Shkodër, 25.04.2019

Thirrje për Studio Produksioni

Pozicioni: Studio produksioni për realizim dokumentari

Titulli i projektit: “Youth WAVE for Human Rights”

Shtyrja e përfundimit të aplikimit: 15 Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Youth Wave for Human Rights” zbatohet në Shkodër në kuadër të Projektit “Të rinjtë në Shqipëri për të Drejtat e Njeriut” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga World Vision në bashkëpunim me Rrjetin e të Rinjve Jugoro-Lindor. Ky projekt ka për qëllim aftësimin dhe fuqizojmin e të rinjve për të ndërtuar komunitete miqësore dhe respektuese ndaj të drejtave të njeriut dhe përfshin zhvillimin e një sërë aktiviteteve që i shërbejnë arritjes së këtij qëllimi.

2. Qëllimi i kontratës

Përcaktimi i termave të angazhimit të studios së produksionit për përgatitjen e dokumentarit për të drejtat e njeriut.

3. Produkti i punës

Dokumentar për të drejtat e njeriut, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të Shkodrës për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut. Ky dokumentar supozohet paralelisht të pasqyrojë edhe punën e bërë në zbatim të këtij projekti por në të njëjtën kohë edhe të adresojë çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut konform projektit.

4. Vendi i zhvillimit të aktivitetit

Aktiviteti do të zhvillohet në hapsirën territoriale të Bashkisë Shkodër dhe Pukë, konkretisht Njesia Administrative Rrethina, Ana e Malit, Rajoni nr. 5 dhe Gomsiqe.

5. Roli dhe përgjegjësitë e studios së produksionit

Aktiviteti do të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe konsiston në:

- Një bashkëpunim të ngushtë me regjizorin për konceptimin, filmimin, editimin, e dokumentarit duke konkluduar me produktin final i gatshëm për transmetim. I gjithë procesi i ndërtimit të këtij dokumentari do të monitorohet nga stafi kordinues i projektit dhe shoqatës “Gruaja tek Gruaja”, të cilët në të njëjtën kohë sdo të jenë edhe mbështetës duke ofruar sygjerime, komente dhe inpute varësisht nga nevoja;
- “Gruaja tek Gruaja” dhe stafi i angazhuar në projekt kanë fjalën e fundit lidhur me produktin final.

Pas nënshkrimit të kontratës regjizori në kordinim me Kordinatorin e Projektit duhet të sigurohet që organizimi i këtij aktiviteti të vecantë të zhvillohet në përputhje të plotë me objektivat e projektit.



6. Kohëzgjatja e kontratës dhe planifikimi i punës

1. Aktiviteti nis menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
2. Brenda 20 ditësh nga fillimi i marrëdhënies së punës duhet të dorëzohet një plan i detajuar pune i mirëpërcaktuar në kohë.
3. Produkti final duhet të jetë i përfunduar deri me datën 31 Dhjetor 2019.

7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

- Experiencë në fushën e punës me, prodhim, editim dokumentarësh/filmash/reportazhesh.
- Aftësi për të punuar brenda limiteve kohore të përcaktuara dhe me standarte të larta profesionalizmi.

8. Dokumentacioni i nevojshëm

- Material (video, dokumentar, film i shkurter, reportazh) i cili demonstroi eksperiencën në këtë fushë.
- Ekstrakt QKR;

9. Pagesa

Mënyra e pagesës do të kryhet varësisht nga vullneti i të kontraktuarit në përfundim të të gjitha detyrimeve të listuara apo me disa transhe duke i lidhur ato me detyra të përfunduara.

Procedura e prokurimit ka një fond limit prej 125'300 (njëqind e njëzet e pesë mijë e treqind) Lekë. Subjekti i interesuar për t'iu përgjigjur ftesës për ofertë duhet të paraqesë ofertën e tij pranë organizatës.

10. Aplikimi

Aplikimi/oferta duhet të dërgohet brenda datës 15.05.2019 me email në adresën: grujatekgrujaja@gmail.com.